



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:136245
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05708161

P.nr.2021:136245

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm Samedin Cena, me zyrtarin ligjor Fatlind Kryeziu, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.A., nga Gjakova për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314, par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP/II.nr.945/21, të datës 25.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të shtetit Kastriot Memaj, palës së K... SH.A përfaqësuar sipas autorizimit nga A.M., dhe të akuzuarit A.A.me mbrojtësin e tij avokat Agim Muhaxhiri, me datë 29.04.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

A.A.,nga i ati ... dhe nëna .., e gjinisë ..., i lindur më dt..... në fshatin ... Komuna e Gjakovës, e tani me banim në rrugën rr ”” nr . . . , Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së mire ekonomike, punon si elektro – instalues, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , me numër personal ..

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse nga data e pavërtetuar e deri me datë 20.01.2021 në shtëpinë e tij në Rr. ... (ish-.... në Gjakovë, me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, e në kundërshtim me dispozitën nenit 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrolleve nga ana e zyrtarëve të K....-it, në datën e lartcekur është konstatuar se i pandehuri, në njësinorin eklektik me

nr.63893807, nuk lejon që të bëhet kontroll dhe në prezencë të zyrtarëve të kontrollës, ka eliminuar ndërprerësin, ku në prezencë të punëtorëve të K.-it, ka eliminuar ndërprerësin, ndërsa pas prezencës së policisë, pranon qasjen deri te njehsori elektrik ku ishte akoma duke punuar rreth eliminimit të ndërprerësit ilegal, ku pas kontrollës është vërtetuar se njehsori ka qenë i pa bllombuar, ku është furnizuar pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar K.-divizioni në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,38,39,40,46, 48,49, 69,70,71 të KPRK-së dhe neneve 242, 358, 364 e 365 të KPPRK-së, i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i përcaktohet:

- I. Dënimi me gjobë në shumë prej një mijë (1000) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- II. Nëse dënimin e shqiptuar me gjobë i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguajë gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do ta zëvendësojë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 50 ditësh, ku një ditë me burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë Euro) si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar K.... SH.A – Divizioni në Gjakovë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Ecuria e procedurës penale

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm duke vepruar sipas udhëzimeve Aktgjykimit PA1.nr.345/22 të datës 24.10.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës me të cilin është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë Departamenti i Përgjithshëm P.nr.318/21 i datës 28.12.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës Gjykatë në rigjykim dhe vendosje, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me qëllim të shqyrtimit të kësaj çështje penale.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë 11.03.2024 dhe me datë 24.04.2024, në të cilat shqyrtime prezent kanë qenë Prokurori i Shtetit, pala e dëmtuar K... Sh.A përfaqësuar sipas autorizimit nga A.M., dhe i akuzuari A.A., me mbrojtësin e tij avokat Agim Muhaxhiri nga Gjakova, ndërsa në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar V.B., SH.K., G.Z., dhe B.H.,

Fjalët hyrëse të palëve

Meqenëse i akuzuari A.A., gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u deklarua i pafajshëm lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, shqyrtimi gjyqësor vazhdoi me fjalën hyrëse të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse deklaroi se në çështjen penale kundër të akuzuarit A.A., edhe në këtë rishqyrtim gjyqësor do të vërtetohet në tërësi gjendja faktike ashtu si që është vërtetuar edhe me Aktgjykimin dënues të kësaj gjykate ku edhe është vërtetuar në tërësi gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë prandaj edhe në këtë seancë të rishqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet përgjegjësia penale e të akuzuarit për veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6, lidhur me par.1 të KPRK-së. Meqenëse kjo çështje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të datës 24.10.2022 është kthyer në rivendosje për shkak të paqartësive sa i përket adresës ku është kryer vepra penale, përkatësisht se ku gjendet shtëpia e të akuzuarit pas shqyrtimit dhe rivlerësimit të dhënave në kallëzimin penal dhe shkresave të tjera e bëj përmirësimin e dispozitivit në rreshtin e parë sa i përket vendit ku është kryer vepra penale ashtu që duhet të jetë në Lagjennë Gjakovë, në rrugën “...” (ish) ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës K. Sh.A, A.M., në fjalën hyrëse deklaroi se mbesim në tërësi pranë fjalës hyrëse të Prokurorit të shtetit duke shtuar se i bashkangjitemi ndjekjes penale si dhe kërkojmë kompensimin e dëmit të shkaktuar nga i akuzuari.

I autorizuari i të akuzuarit avokat A.M., në fjalën hyrëse deklaroi se e kundërshtojmë në tërësi Aktakuzën PP.nr 945/21 të datës 25.06.2021 për faktin se e njehta është e parregullt, objekti i shtëpisë në rrugën “...” përkatësisht ish-rruga dhe njëtori i shtëpisë nuk është në emër të akuzuarit A.A., por evidentohet në emër të R.A., ndërsa sa i përket pjesës së keqpërdorimit të energjisë eklektike përkatësisht veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314, par 6 lidhur

me par 1 të KPRK-së kjo nuk qëndron për faktin se gjykatës do të ja prezantojmë një raport të shpenzimit të energjisë eklektike nga data 01.01.2019 deri me datën 31.12.2023, po ashtu deklarata e dëshmitarëve që sot u identifikuan që janë prezent janë në kundërtënie me njëra tjetrën me dëshmitë të dëshmitarit jo prezent.

I akuzuari A.A., në fjalën hyrëse deklaroi se e mbështes në tërësi fjalën hyrëse të avokatit tim dhe nuk kam çka të shtoj.

Deklaratat e dëshmitarëve

Edhe në procedurë të rigjyimit me propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit avokat Agim Muxhaxhiri në cilësi të dëshmitarëve u dëgjuan dëshmitarët V.B., SH.K., G.Z., dhe B.H., Dëshmitari V.B., me rastin e dëshmisë së tij të dhënë me datë 11.03.2024 deklaroi se unë qëndroj pranë deklaratës që e kam dhënë pranë kësaj gjykate me datë 20.12.2021 dhe e njejta mbetet ashtu siç kam deklaruar si herën e parë, ndërsa Prokurori i shtetit shtoi se meqenëse dëshmitari në fjalë në dëshminë e tij të mëhershme ka qenë shumë i qartë dhe ka përshkruar në tërësi veprimet inkriminuese të të akuzuarit A.. duke sqaruar ne detaje parregullsitë që i kanë gjetur ditën kritike së bashku me kolegët e tij te shtëpia e të akuzuarit, prandaj deklaroj se nuk kam pyetje tjera shtesë për dëshmitarin.

Në pyetjet e mbrojtësit të të akuzuarit avokat Agim Muhaxhiri dëshmitari u përgjigj se në ditën kritike kemi pasur kontroll të rregullt në këtë lagje dhe urdhërin e kemi marrë nga koordinatori F.P., dhe kemi qenë unë V.B., B.H., SH.K., dhe G.Z.,

Në pyetjen se më të arritur ju te shtëpia e të akuzuarit a ka qenë e mbyllur kutia apo ka qenë e hapur, dëshmitari u përgjigj se si fillim nuk na ka lejuar që t'i afrohem fare orës, pastaj jemi tërhequr dhe kemi njoftuar policinë, pasi që ka ardhur policia pas 30 minutave, gjatë asaj kohe deri sa ka ardhur policia konsumatori A.A., e ka çmontuar kapakun e ormanit, e ka hequr ndërprerësin, kur jemi afruar te ora kapaku ka qenë i hapur dhe ka qenë në tokë, blloba ka qenë e dëmtuar dhe ndërprerësi ka qenë i hequr, ndërprerësi ka qenë i montuar në orman dhe e ka çmontuar në prezencë tonën në largësi prej 10 m.

Në pyetjen se në ndërprerës a ka pasur të lidhur kabllo dhe ku ka shkuar ky kabllo, dëshmitari u përgjigj se ka pasur të lidhur një kabllo prej KPO i cili ka shkuar në ndërprerës, konsumatori e ka këputur kabllon e agregatit i cili ka qenë në KPO dhe vjen deri në ndërprerësin që është i vendosur në orman, me këtë ndërpres i cili ka qenë me dy kahje 1 dhe 2 i cili ka mund të manipulohet, 1 ka mund të regjistroj ora dhe 2 të mos e regjistroj.

Në pyetjen se qat kabllo a e ka matur dikush, dëshmitari u përgjigj se jo nuk kemi mundur ta matim pasi që nuk kemi pasur qasje as te kabllo as te njëtori, ndërsa në pyetjen po ndërprerësin a e keni shqyrtuar a është në rregull apo jo, i njejti u përgjigj se jo ndërprerësi ka qenë në tokë dhe është larguar nga vetë i akuzuari.

I akuzuari A.A., pyet dëshmitarin a ju kam lutur me mat ndërprerësin a është i djegur, dëshmitari përgjigjet se jo nuk na ke lutur madje nuk ke dhënë qasje te njëtori deri sa ka ardhur policia. Në pyetjen se kjo kabllo 2.5 a ka qenë e lidhur me ndërprerës, dëshmitari u përgjigj se ditën kritike vetëm e kam parë duke e çmontuar ndërpresin dhe njëtorin dhe duke i larguar kabllo.

Dëshmitari SH.K., me rastin e dëshmisë së tij të dhënë me datë 11.03.2024 deklaroi se unë qëndroj pranë deklaratës që e kam dhënë pranë kësaj gjykate me datë 20.12.2021 dhe e njehta mbetet ashtu siç kam deklaruar si herën e parë, ndërsa Prokurori i shteti shtoi se meqenëse dëshmitari në fjalë në dëshminë e tij të mëhershme ka qenë shumë i qartë dhe ka përshkruar në tërësi veprimet inkriminuese të të akuzuarit Arben duke sqaruar në detaje parregullsitë që i kanë gjetur ditën kritike së bashku me kolegët e tij te shtëpia e të akuzuarit, prandaj deklaroj se nuk kam pyetje tjera shitesë për dëshmitarin.

Në pyetjen e të autorizuarit të akuzuarit Av.Agim Muhaxhiri se ditën kritike me datë 20.01.2021 a keni qenë në shtëpinë e të pandehurit për kontroll, a mund të na tregoni se çfarë keni parë në kutinë ku është njëtori elektrik dhe kutinë KPO, dëshmitari u përgjigj se po kemi qenë me datë 20.01.2021 në kontroll në shtëpinë e të akuzuarit, në prezencë të gjithë punëtorëve që kemi qenë aty e ka ndalur rrymën në KPO ka shkuar te njëtori dhe ka punuar diçka te njëtori, ku e ka larguar një ndërprerës 1 0 2, ky ka qenë i lidhur prej KPO në ndërprerës dhe prej ndërprerësit vazhdon dhe shpërndahet në shtëpi.

Në pyetjen se prej ndërprerësit kalon në shtëpi përmes njëtorit apo pa u regjistruar fare, dëshmitari u përgjigj se ka qenë jashtë njëtorit e lidhur.

Në pyetjen se a të kujtohet çfarë kabllo ka qenë i lidhur, dëshmitari u përgjigj se po ka qenë kabllo 5x2.5mm dhe se nuk më kujtohet saktë a e kemi fotografuar këtë kabllo.

Në pyetjen se në njëtori a ka pasur kabllo tjetër të lidhur, dëshmitari u përgjigj se njëtori e ka pasur kabllon veç dhe ndërprerësi kabllon veç. Në pyetjen se cila është kabllo që e ka furnizuar shtëpinë pa kaluar nëpër njëtori, dëshmitari u përgjigj se jo në këtë rast, arsyeja është se personi në fjalë e ka demoluar njëtorin, ndërprerësin i ka qitur në tokë, pastaj pasi e ka ndërprerë rrymën dhe ka çmontuar krejt, në prezencë të policisë kemi pasur qasje.

Në pyetjen se ju apo dikush prej kolegëve tuaj a e keni shqyrtuar kabllon 2x2.5 a është e djegur dhe ndërprerësin 1 0 2 a është i djegur, dëshmitari u përgjigj se po e kemi shqyrtuar dhe nuk kanë qenë të djegura, po unë së bashku me grupin e kolegëve.

Në pyetjen e të akuzuarit A.A., rryma që vjen prej KPO a hyn në njëtori apo në ndërprerës, dëshmitari u përgjigj se në rastin konkret kanë qenë të lidhura dy kabllo njëra ka qenë anashkalim dhe ndërsa tjetra ka qenë e lidhur me njëtori.

Dëshmitari G.Z., me rastin e dëshmisë së tij të dhënë me datë 11.03.2024 deklaroi se unë qëndroj pranë deklaratës që e kam dhënë pranë kësaj gjykate me datë 20.12.2021 dhe e njehta mbetet ashtu siç kam deklaruar si herën e parë, ndërsa Prokurori i shtetit shtoi se meqenëse dëshmitari në fjalë në dëshminë e tij të mëhershme ka qenë shumë i qartë dhe ka përshkruar në tërësi

veprimet inkriminuese të të akuzuarit A... duke sqaruar ne detaje parregullsitë që i kanë gjetur ditën kritike së bashku me kolegët e tij te shtëpia e të akuzuarit, prandaj deklaroj se nuk kam pyetje tjera shtesë për dëshmitarin.

Në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit Av. Agim Muhaxhiri se prej KPO deri në kutinë ku është njehsori elektrik a keni vërejtur ndonjë kabllo 5x2.5, dëshmitari u përgjigj se po e kemi vërejtur, aty ka qenë një kabllo 5x2.5mm. Në pyetjen a e keni fotografuar atë kabllo, dëshmitari u përgjigj se besoj që është në shkresa të lëndës nuk më kujtohet saktë.

Në pyetjen atë kabllo a ka qenë edhe një ndërprerës apo qelës të cilin ju e quani 1 0 2, dëshmitari u përgjigj se kur na është dhënë qasje te njehsori elektrik çdo gjë ka qenë e çmontuar dhe qelësi ka qenë në kutinë e njehsorit, ndërsa në pyetjen a e keni testuar kabllon dhe ndërprerësin a janë funksional, dëshmitari u përgjigj se jo nuk e kemi testuar.

Në pyetjen se a ka qenë me ju B.H., dhe kur ka hyrë në oborr para jush apo pas jush, dëshmitari u përgjigj se po ka qenë prezent, dhe ka hyrë ne oborr para meje, ndërsa në pyetjen se cili prej jush ka pasur instrument me mat burimin elektrik, dëshmitari u përgjigj se çdo sen ka qenë e çmontuar kur kemi arritur në vendin e ngjarjes.

Në pyetjen e të akuzuarit A.A., sa kabllo 5x2.5 mm kanë qenë në oborr te unë, dëshmitari u përgjigj se me sa më kujtohet mua ka qenë vetëm një.

Dëshmitari B.H., me rastin e dëshmisë së tij të dhënë me datë 24.04.2024 në pyetjet e Prokurorit të shtetit a ju kujtohet që keni dhënë deklaratë me datë 25.11.2021 në shqyrtim gjyqësor, a mund të kujtoheni se çfarë keni deklaruar dhe se a mbeteni pranë asaj deklarate, i njejtë u përgjigj se po më kujtohet dhe qëndroj pranë asaj deklarate që e kam dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Më tej Prokurori i shtetit shtoi se meqenëse dëshmitari u deklarua se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës 25.11.2021 si dhe duke shtuar se nga koha se kur ka dhënë deklaratë ka kaluar përafërsisht 3 vite prokuroria vlerëson se nuk është e nevojshme t'i parashtrohet ndonjë pyetje tjetër dëshmitarit për arsye se dëshmitari në këtë seancë ka sqaruar në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me këtë çështje penale dhe veprimet e ndërmarra si zyrtar i K...-s si dhe lidhur me keqpërdorimin e bërë të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës, shtuar këtu edhe faktin se edhe vërejtjet Gjykatës së Apelit me rastin marrjes së vendimit nuk kanë qenë drejtuar dëshmitarëve, bazuar në këto rrethana prokuroria vlerëson se nuk është e nevojshme të parashtrohet ndonjë pyetje për sqarim të ndonjë rrethane shtesë.

Në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit avokat Agim Muhaxhiri se me datën 20.01.2021 kur keni qenë gjatë kontrollës në oborrin e të akuzuarit a keni hyrë në oborr për ta kontrolluar, dëshmitari u përgjigj se po kemi hyrë në oborr, ku fillimisht kemi thirrur, konsumatori ka qenë në oborr dhe nuk na ka lejuar të kemi qasje për kontrollimin e njehsorit elektrik.

Në pyetjen ju keni parë një kabëll se keni dyshuar se nuk është ne rregull nga njehsori deri te KPO, dëshmitari u përgjigj se kablli nga KPO e deri te ndërprerësi 102 sipas konstatimit tonë

nuk ka qenë në rregull, ka qenë i lidhur jashtë matësit të njehsorit elektrik, ndërsa në pyetjen se ndërprerësi 102 a e keni matur a ka qenë në rregull apo jo, dëshmitari u përgjigj se jo nuk e kemi matur pasi që konsumatori në prezencën tonë e ka bërë demolimin e ndërpresit nga ormani e ka hequr në tërësi.

Në pyetjen se kur e damkosni njësorin elektrik a bëni procesverbal dhe mbani evidencë për atë njehsor se kur është dhe kush e ka damkosur, dëshmitari u përgjigj se po nëse është fjala për bllobimin, bëhet me procesverbal dhe numrat e bllobave ceken në procesverbal dhe në fund nënshkruajnë personat prezent të epikës që e kanë bërë bllobimin

Në pyetjen me datë 20.01.2021 keni konstatuar se nuk ekziston blloba në njehsor në bazë të shkahun e keni konstatuar këtë shkelje se kush para jush e ka bllobu këtë njësor, dëshmitari u përgjigj se nuk e kemi cekur ne se kush e ka dëmtuar bllobën, ne vetëm e kemi përshkruar gjendjen reale të njehsorit në momentin e kontrollës.

Në pyetjen e të akuzuarit A.A., se a është e vërtet se ka qenë i lidhur një kabëll 5x2.5 në KPO, dëshmitari u përgjigj se ne kemi bërë kontrollin e njehsorit dhe pikës matëse pasi që kanë arritur asistencën e policisë dhe kablli ka qenë i këputur dhe shihet dhe në foto se në prezencën tonë ka bërë eliminimin e kabllit, pas testimit të kabllit të kyqur në rrym, rryma është përcjellur te ndërprerësi 102 i cili ka qenë jashtë matjes.

Në pyetjen se a ka pasur inverter - UPS të lidhur për shfrytëzim në shtëpi, dëshmitari u përgjigj se nuk me kujtohet se a ka pasur te instaluar inverter. Në pyetjen se furnizimi deri në KPO a është monofaz apo trefazor, dëshmitari u përgjigj se furnizimi për një njehsor ka qenë kabëll i veçantë trefazor, ndërsa në pyetjen kablllo 5x2.5 a kanë qenë në dalje, dëshmitari u përgjigj se nuk e di se a ka pasur kablllo tjera të lidhura.

Në pyetjen e gjyqtarit të çështjes se ju me herët deklaruat se i akuzuari nuk iu ka lejuar qasjen te njësori elektrik ndërsa më pas na shpjeguat se e keni bërë kontrollën, dëshmitari u përgjigj se pasi nuk na ka lejuar qasje te njehsori kemi dalur jashtë oborrit të shtëpisë, kemi thirrur asistencën e policisë dhe pasi kanë arritur asistencën e policisë na ka ofruar qasjen te njësori elektrik.

Në pyetjen se në momentin kur e keni bërë kontrollimin e njehsorit, a ka pasur blloba të vendosura, dëshmitari u përgjigj se jo nuk ka qenë i bllobuar fare dhe ne nuk kemi hasur asnjë bllob. Ndërsa në pyetjen a ka ndodhur ndonjëherë që gjatë kontrolleve gjatë punës tuaj që njehsori të mos ketë bllobë dëshmitari u përgjigj se njësori duhet të jetë i bllobuar, gjatë punës kemi hasur edhe në raste kur nuk ka pasur blloba, ku fillimisht e bëjmë fotografimin e njehsorit e hapim kapakun e njehsorit bëjmë kontrollimin e hyrje daljeve a janë ne rregull, nëse janë në rregull mbetet konstatimi se njësori ka qenë i pa bllobuar dhe nëse ka ndërhyrje përpilojmë procesverbal të gjendjes siç është.

Provat materiale të administruara

Nga leximi i procesverbalit mbi konstatimin e gjendjes faktike me nr. 0011179 të datës 20.01.2021 Gjykata konstatoi se gjatë kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit A.A., që ndodhet në Gjakovë në Rr. ,.... (ish-.....) të njehsorit të tij eklektik 63893807, i njëjti nuk ka lejuar që të bëhet kontrolli nga ana e zyrtarëve të K...-it dhe në prezencë të zyrtarëve të kontrollës ka eliminuar ndërprerësin, ndërsa pas prezencës së policisë, pranon qasjen deri te njehsori elektrik ku ishte akoma duke punuar rreth eliminimit të ndërprerësit ilegal, ku njehsori ka qenë i pa bllobuar, pastaj është bllobuar nga punëtorët e K...-it, ku është konstatuar se është furnizuar me energji elektrike pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike.

Nga shikimi dhe leximi i faturës mbi dëmin e shkaktuar me nr. DGJHP219695 të datës 25.01.2021, Gjykata konstatoi faktin se konsumatori e ka dëmtuar kompaninë e lartcekur në vlerë prej 1350.30 €, me anë të kësaj fature është përcaktuar rikthimi i humbjeve nga ana e K...-it.

Nga shikimi dhe leximi i faturës mbi kalkulimin e rikthimit të humbjeve me nr .341314, datë 22.01.2021, gjykata konstaton se K... Distrikti në Gjakovë ka bërë raportin e kalkulimit për energjinë për faturim të shpenzimit të paautorizuar, se i akuzuari e ka dëmtuar kompaninë e lartcekur;

Nga shikimi dhe leximi i njoftimit me nr.rendor.00000 të datës 07.05.2021, Gjykata konstatoi se Kompania K... e kishte njoftuar paraprakisht të pandehurin për keqpërdorimin e energjisë elektrike dhe e kishte ftuar të njëjtin që brenda afatit prej 7 ditësh të paraqitet në zyret e K... për të arritur marrëveshje për pagesën e dëmit të shkaktuar.

Gjykata administroi dhe vlerësoi edhe Transaksionin e konsumatorit për periudhën 01.01.2021-31.12.2023 deri me datën 31.12.2023 dhe nga kjo erdhi në përfundim se kjo provë nuk pati ndikim në një vendosje ndryshe, pasi që me këtë provë kontestohet lartësia e dëmit dhe jo elementet e veprës penale dhe veprimet e të akuzuarit. Meqenëse gjykata nuk mundi ta vërtetojë në mënyrë të saktë lartësinë e dëmit, të cilën e konteston i akuzuari, atëherë të dëmtuarën e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e dëmit.

Nga shikimi i fotografive që gjenden në shkresat e lëndës Gjykata konstatoi se si i akuzuari eliminon keqpërdorimin në njehsorin e tij elektrik në prezencë të punëtorëve të K.-it, të cilët kishin shkuar për kontroll të njehsorit të tij elektrik, në të cilat shihet mënyra e kryerjes së veprës penale.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari A.A deklaron se i kam të qarta të drejtat e mija në këtë shqyrtim gjyqësor e shfrytëzoi të drejtën dhe do të mbrohem ne heshtje.

Fjalët përfundimtare të palëve

Para dhënies së fjalëve përfundimtare palët deklarojnë se heqin dorë nga caktimi i seancës për matjen e dënimit.

Prokurori i shtetit Kastriot Memaj në fjalën e vetë përfundimtare deklaroi se prokuroria e shtetit mbetet edhe me tutje pranë fjalës përfundimtare të parashtruar me date 20.12.2012 në shqyrtim gjyqësor ku edhe është bërë elaborimi i të gjitha provave të administruara në shqyrtim gjyqësor po ashtu edhe i veprimeve inkriminuese të akuzuarit, shtuar kësaj prokuroria vlerëson se edhe në këtë rigjykim u vërtetua me pa mëdyshje gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës ku të gjithë dëshmitarët mbetën pranë deklaratave të dhëna në shqyrtimin e kaluar andaj konsiderojmë se me veprimet e të akuzuarit janë formuar të gjitha elementet e veprës penale me të cilën i pandehuri akuzohet. Vlen të potencohet fakti se kjo çështje penale është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit kryesisht për shkak të adresës gjegjësisht vendit të kryerjes së veprës penale sipas Aktgjykimit të datës 28.12.2021 është konstatuar si vend i kryerjes se veprës penale fshati, Komuna e Gjakovës kjo çështje konform Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është rregulluar me precizimin e aktakuzës në fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit në fjalën hyrëse të datës 11.03.2024, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se vend i kryerjes së veprës penale është Lagjia në Gjakovë Rr “...” (ish –) ndërsa pjesa tjetër e akuzës mbetet e pa ndryshuar. Andaj nga të lartcekurat i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagesën e shpenzimeve të proceduarës penale, ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara sipas KPRK-së.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës në fjalën përfundimtare deklaroi se i bashkangjitem fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit duke shtuar se i bashkangjitem ndjekjes penale të akuzuarit dhe duke kërkuar nga gjykata që krahas dënimit meritohet ta obligoj të akuzuarin edhe në kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kjo vepër penale në shumën prej 1350.30 Euro i cili dëm është llogaritur në bazë të Ligjit për Energjinë Elektrike, përkatësisht Rregulloren për procedurën për identifikimin dhe parandalimit të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, përkatësisht nenit 13 të aprovuar nga ZRRE e gjithë kjo me qëllim të ekonomizimit të procedurës dhe mos krijimit të shpenzimeve shtesë.

I autorizuari i të akuzuarit avokat Agim Muhaxhiri në fjalën e vetë përfundimtare deklaroi se nga provat e administruara u dëshmuar se aktakuza PP/II.nr.945/21 e datës 25.06.2021 e përmirësuar me datë 11.03.2024 e Prokurorisë Themelore në Gjakovë nuk u argumentua me asnjë provë, për faktin se provat materiale – foto dokumentacioni të cilat janë të prekshme nuk argumentojnë se i mbrojturi im e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, po ashtu dëshmitë e dëshmitarëve të proceduar nuk janë unike çka do të thotë se aktakuza është ngritur me pohimet e dëshmitarëve jo unik, përjashtimisht unik ishte vetëm shprehja keqpërdorim por e pa argumentuar e cila shprehje është thënë me hamendje – supozim.

Nga arsyet e cekura me lartë i kërkoj gjykatës që të mbrojturin tim ta liroj nga përgjegjësia penale.

I akuzuari A.A., fjalën e vetë përfundimtare deklaroi se mbështes fjalën përfundimtare të paraqitur nga mbrojtësi im dhe konsideroj se aktakuza ndaj meje ka qenë e qëllimshme për shkak të profesionit tim pasi që edhe unë punoj si elektrikist – monter.

Gjetjet e gjykatës dhe vlerësimi i provave

Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë dëshmitarëve okular të vendit të ngjarjes, V.B., B.H., SH.K., G.Z., punëtorë zyrtar të K... në Gjakovë, pasi që dëshmia e tyre është në përputhje të plotë me provat materiale të cilat u administruan gjatë shqyrtimit gjyqësor siç janë: procesverbal i me nr.0011179 i datës 20.01.2021, fatura mbi dëmin e shkaktuar me nr. DGJHP219695 e datës 25.01.2021, me foto dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës si dhe nga vetë deklaratat e të akuzuarit Arben i cili në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar faktin se fillimisht ka ndërhyrë në KPO për të ndërprerë energjinë elektrike, e më pas ka punuar në njehsorin elektrik, ka hequr ndërpresin në prezencë të punëtorëve të K.-it, të cilët fillimisht nuk i ka lejuar që të bëjnë kontrollin e njehsorit të tij elektrik. Dëshmitarët V.B., B.H., SH.K., G.Z., punëtorë zyrtar të K. në Gjakovë, si dëshmitar okular të vendit të ngjarjes, sqaruan në mënyrë të hollësishme gjendjen faktike, deklaratat e tyre ishin në përputhshmëri të plotë njëri me tjetrin të cilët deklaruan se ditën kritike kur kanë qenë në kontroll konsumatori po sa ka dalur nga dera e shtëpisë ju ka thënë se nuk bën me kontrollua njehsorin e tij elektrik, i ka larguar nga oborri por ata kanë pritur para dyerve të oborrit të shtëpisë, duke pritur përforcimet e policisë pasi që i njëjti nuk i ka lejuar të bëjnë kontrollën, fillimisht i akuzuari ka shkuar te vetura e tij e cila ndodhej në oborrin e shtëpisë, e ka marrë një çantë me mjetet e punës dhe ka shkuar te KPO ka shkyç diçka në KPO ku kjo ndodhej mbrapa shtëpisë, është kthyer dhe i njëjti ka ardh te njehsori dhe ka filluar të çmontojë keqpërdorimin, siç shihet edhe në fotot. Pasi ka ardhur policia i akuzuari veç e ka kryer punën e eliminimit të keqpërdorimit, te njehsori ka hequr ndërpresin komplet që shkon me hyrje dhe dalje, ka eliminuar keqpërdorimin, dhe pastaj punëtorët e K... e kanë bërë verifikimin e njehsorit pasi kanë ardhur policia, kanë konstatuar se njehsori ka qenë pa kapak dhe pa bllomba distributive, theksojnë se në momentin kur hasin në një njehsor pa bllomba atëherë automatikisht kuptojmë se aty ka pasur keqpërdorim – ndërhyrje te njehsori. Në të gjitha fotot, të cilat i kanë bërë punëtorët e K...-it, shihen shumë qartë veprimet e të akuzuarit, ku i njëjti ka hequr ndërpresin nga njehsori dhe e ka lënë në ballkon, shihet duke i rregulluar kabllot, duke i kthyer në vend të vetin ashtu siç duhet të jenë, pasi që i njëjti me profesion është elektrikist dhe kur është bërë demonstrimin janë lidhur telat ku ka qenë i vendosur ndërpresi është konstatuar se kjo ka qenë e lidhur në KPO dhe pikërisht me këtë kabllo është keqpërdorë energjia elektrike, nuk është regjistruar energjia e shpenzuar elektrike. Shtojnë se nëse nuk ka pasur keqpërdorim atëherë pse nuk na ka lejuar që të bëjmë kontrollën e njehsorit elektrik, dhe nëse ndërpresi ka qenë i djegur siç po pretendon i akuzuari ne këtë do ta kishim konstatuar dhe nuk ka pasur nevojë që i akuzuari paraprakisht në prezencën tonë me e heq ndërpresin.

Këto manipulime dhe keqpërdorime të energjisë elektrike, janë të cekura edhe në procesverbalin me nr.0011179 të datës 20.01.2021 ku është konstatuar se gjatë kontrollit në shtëpinë e të

akuzuarit A.A.të njehsorit të tij eklektik 63893807, i njëjti nuk ka lejuar që të bëhet kontrolli nga ana e zyrtarëve të K...-it dhe në prezencë të zyrtarëve të kontrollës ka eliminuar ndërprerësin, ndërsa pas prezencës së policisë, pranon qasjen deri te njehsori elektrik ku ishte akoma duke punuar rreth eliminimit të ndërprerësit ilegal, ku njehsori ka qenë i pa bllobuar, pastaj është bllobuar nga punëtorët e K...-it, ku është konstatuar se është furnizuar me energji elektrike pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike.

Po ashtu edhe me faturën mbi dëmin e shkaktuar me nr. DGJHP219695 të datës 25.01.2021, ku konstohet fakti se konsumatori e ka dëmtuar kompaninë e lartcekur në vlerë prej 1350.30 €, me anë të kësaj fature është përcaktuar rikthimi i humbjeve nga ana e K...-it.

Nga foto – dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës ku shihet se si i akuzuari eliminon keqpërdorimin në njehsorin e tij elektrik në prezencë të punëtorëve të K...-it, të cilët kishin shkuar për kontroll të njehsorit të tij elektrik, në të cilat shihet mënyra e kryerjes së veprës penale.

Andaj në bazë të gjitha këtyre provave pa mëdyshje u vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi se me të vërtetë i akuzuari ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrolleve nga ana e zyrtarëve të K...-it, është konstatuar se i pandehuri, në njehsorin eklektik me nr.63893807, nuk lejon që të bëhet kontrolli dhe në prezencë të zyrtarëve të kontrollës, ka eliminuar ndërprerësin, ku në prezencë të punëtorëve të K...-it, ka eliminuar ndërprerësin, ndërsa pas prezencës së policisë, pranon qasjen deri te njehsori elektrik ku ishte akoma duke punuar rreth eliminimit të ndërprerësit ilegal, ku pas kontrollës është vërtetuar se njehsori ka qenë i pa bllobuar, ku është furnizuar pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të akuzuarit se kinse këto veprime i ka kryer sepse ndërprerësi i është djegur, ndërsa në anën tjetër vetë pohon faktin se ndërprerësi i rrymës, mund të përdoret për gjenerator, por që ai nuk ka gjenerator, ka inventar dhe nuk i shërben, por të njëjtin e ka vendosur para 10 vite dhe ashtu ka mbetur, atëherë ku ka qenë nevoja me e ndërrua ndërprerësin elektrik që e ka pas në tabelën e njehsorit të tij elektrik mu në momentin kur kanë shkuar punëtorët e K...-it për kontroll të njehsorit edhe po të ishte i djegur siç pretendon i akuzuari, një mbrojtje e tij është e pa pranueshme dhe nuk ka mbështetje në asnjë provë që është administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe si të tillë gjykata nuk ia falë besimin pasi që qëllimi i vetëm është që të shmangej nga përgjegjësia penale, po ashtu me provat të cilat janë administruar janë vërtetuar të gjitha elementet e veprës penale nga neni 314 të KPRK-së, sepse është vërtetuar se i akuzuari ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa matje, e po ashtu pasoja e kësaj vepre penale e që është shkaktimi i dëmit përkatësisht mos pagimin e shpenzimit të energjisë elektrike, prandaj vlerësojmë se në veprimet e të akuzuarit tani më janë vërtetuar të gjitha elementet e veprës penale.

Andaj në bazë të të gjitha këtyre arsyeve gjykata vërtetoi përgjegjësinë e tij, i cili me dashje ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të akuzuarit A.A., i cili i propozon gjykatës që të bëhet një ekspertizë të lëmisë përkatëse e njehsorit elektrik, eventualisht edhe kabllor elektrike dhe KPO, që të vërtetohet se kinse ai nuk e ka bërë këtë keqpërdorim. Për Gjykatën ky propozim nuk është i nevojshëm, për faktin se punëtorët e K...-it në momentin kur kanë bërë kontrollën kanë vërejtë se njehsori ka qenë pa bllobë distributive dhe të njëjtit pas kontrollës e kanë montuar këtë bllobë, si dhe është vërtetuar fakti se keqpërdorimin i njëjti e ka bërë përmes ndërpresit që e ka pasur të vendosur të tabelën e njehsorit të tij elektrik, prandaj është i pa nevojshëm caktimi i një eksperti pasi që tani blloba e hequr më parë, siç pohuan dëshmitarët, janë vendosur në njehsorin e tij elektrik, sa i përket kabllor elektrike dhe KPO që të bëhet një ekspertizë e veçantë gjykata konstaton se është e panevojshme, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk është kontestues funksionimi i njehsor, pasi që ndërhyrja në njehsor është bërë përmes lidhjes me ndërprerës dhe jo ndërhyrje tjera në njehesor, andaj Gjykata e konsideroi si të pa nevojshme caktimin e një ekspertize të një eksperti të lëmisë përkatëse.

Për gjykatën ishte kontestues fakti se në cilin vend është kryer vepra penale, andaj duke vepruar në bazë të udhëzimeve të Gjykatës së Apelit gjatë këtij shqyrtimi vërtetoi se vepra penale është kryer në shtëpinë e të akuzuarit A.A. e cila gjendet në rrugën “...” (ish – ...) në Lagjen ..., në Gjakovë. Fakt këtë që e vërtetoi nga provat në shkresat e lëndës siç janë Kallëzimi penal me numër 01/12222 i datës 22.06.2021 i parashtruar nga e dëmtuara K..., Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike me nr.0011179 të datë 20.01.2021,

Për gjykatën konstestuese ishte edhe fakti se kush është pronar i njehsorit dhe kush ka bërë ndërhyrje në njehsor, përkatësisht lidhjen për shfrytëzimin e paligjshëm të energjisë elektrike. Andaj, në këtë drejtim Gjykata vlerësoi dhe shqyrtoi pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit Avokat Agim Muhaxhiri se njehsori elektrik nuk figuron në emër të të akuzuarit A.A., por në emër të personit R.A.,

Nga gjendja faktike e vërtetuar gjatë këtij shqyrtimit, gjykata pa mëdyshje vërtetoi faktin se është e vërtetë se njehsori është i regjistruar në emër të personit R.A. i cili është djali i të akuzuarit A.A., pronar i shtëpisë është i akuzuari A.A., si dhe në momentin e kontrollin me datë 20.01.2019 nga punëtorët e K... i njëjti është hasur duke manipuluar me njehsorin elektrik, e duke u nisur nga fakti se i akuzuari është me profesion elektrikist të cilin fakt e ka pohuar gjatë tërë këtij shqyrtimi gjyqësor, gjykata ka vërtetuar faktin se ndërhyrjen në njehsor e ka bërë i akuzuari A.A., i cili në ditën kritike është hasur nga dëshmitarët duke manipuluar me këtë njehsor.

Po ashtu gjykata, nga dëgjimi i dëshmitarëve gjykata vërtetoi se në kohën e kryerjes së kontrollit njehsori ka qenë i pa bllobuar e që duke u nisur nga neni 61 i Ligjit për Energjinë, par.1, nënpar.1.4, pika 1.4.2 parashihet se: *“çdo person që ndryshon çfarëdo njehsori që përdoret për matjen e sasisë së energjisë elektrike me të cilin është furnizuar cilido objekt nga furnizuesi i autorizuar, ose e pengon njehsorin e tillë apo matësin nga regjistrimi i saktë i sasisë së energjisë elektrike të shpenzuar dënohet me gjobë ose me burgim sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Për qëllime të këtij paragrafi, ndërhyrja në një pajisje matëse ose në matjen e energjisë elektrike përfshin, por nuk kufizohet vetëm në veprat në vijim: largimi i paautorizuar ose dëmtimi i një vule apo blombe zyrtare të vendosur në pajisjen matëse nga një*

person i autorizuar me qëllim të sigurimit të njehsorit”, andaj në rastin konkret nga të gjitha deklaratimet e dëshmitarëve dhe nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar pa mëdyshje se në kohën e ushtrimit të kontrollit nga punëtorët e K... njehsori nuk ka pasur blombë zyrtare fare.

Duke u nisur përmbajtja e nenit 314, par.1 të KPRK-së që parasheh se: *“Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”,* gjykata erdhi në përfundim se kjo veprë penale mund të kryhet nga çdo person dhe jo vetëm nga personi në emër të të cilit është i regjistruar njehsori, andaj edhe në rastin konkret për gjykatën nuk është kontestuese se kush ka ndërhyrë në njehsor, pasi që nga të gjitha provat dhe deklaratimet e dëshmitarëve është vërtetuar pa mëdyshje se ndërhyrjet në njehsor i ka bërë i akuzuari A.A.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, është baba i dy fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, gjendjen e tij ekonomike, sjelljet korrekte në gjykatë, sjelljet e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale, më parë ka qenë i pa dënuar, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata morri parasysh peshën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, intensiteti i rrezikimit apo dëmit të vlerës së mbrojtur, shkallën e lartë të përgjegjësisë penale – dashjen për të kryer këtë veprë penale.

Andaj duke marrë parasysh këto rrethana gjykata të njëjtin e dënoi dhe i shqiptoi dënim sikurse është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, personalitetin e tij, dhe se ky dënim i shqiptuar ndaj tij do të arrijë qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 38 të KPRK-së. dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe par.2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPRK-së si dhe për shpenzimet për programin e kompensimit të viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesa pasurore – juridike

E dëmtuara K...Sh.A për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Këtë vendim gjykata e mori për faktin se edhe pse pala e dëmtuar deklaroi se dëmi i shkaktuar është në shumën prej 1350.30 Euro në bazë të faturës, megjithatë gjykata duke u nisur nga fakti se i pandehuri në tërësi e konteston lartësinë e dëmit, gjykata konsideron se duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPPK-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë andaj gjykata nuk mund të merr vendim lidhur me këtë çështje.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.2021:136245, më datë 20.05.2024

Zyrtari ligjor
Fatlind Kryeziu

Gjyqtari
Samedin Cena

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.